

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”
FAKULTETI I FILOLOGJISË
DEGA LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Kontributi i Bedri Dedjes në letërsinë për fëmijë

Mentori:

Prof. Ass. dr. Besim Muhadri

Kandidatja:

Fatlinda Gjocaj

Gjakovë, 2017

Përmbajtja

Hyrje.....	5
<i>Objekti dhe motivimi i temës.....</i>	5
<i>Qëllimi.....</i>	5
<i>Metodologjia e punës.....</i>	5
Kapitulli i parë.....	6
1. Jeta dhe veprimtaria e Bedri Dedjes.....	6
1.1 <i>Jeta e autorit.....</i>	6
1.2 <i>Veprimtaria e Bedri Dedjes.....</i>	7
1.3 <i>Veprat.....</i>	8
Kapitulli i dytë.....	10
2. <i>Përrallat fantastike të Bedri Dedjes.....</i>	10
2.1 <i>Përralla popullore mbi kafshët.....</i>	10
2.2 <i>Republika e 1100 çudirave.....</i>	11
2.3 <i>Përralla njëmbëdhjetëkatëshe.....</i>	11
Kapitulli i tretë.....	13
3. <i>Novela.....</i>	13
3.1 <i>Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit.....</i>	13
3.2 <i>Një udhëtim i rrezikshëm.....</i>	14
3.3 <i>Shkolla e pyllit.....</i>	16
3.4 <i>Artan borizani dhe çeta e tij.....</i>	17
3.5 <i>Tregimtari Bedri Dedja.....</i>	18
3.6 <i>Kallëzimet e gjyshe Pastërtores.....</i>	18
Kapitulli i katër.....	19
4. <i>Romanet e Dedjes.....</i>	19
4.1 <i>Kalamajtë e pallatit tim.....</i>	19
4.2 <i>Kacimicrri rreth globit.....</i>	21
4.3 <i>Qyteti me tri kështjella.....</i>	22
4.4 <i>Presidenti i Planetit të kuq.....</i>	24

Kapitulli i pestë.....	26
<i>5. Studimi për periodizimin e historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë.....</i>	<i>26</i>
<i>5.1 Mendime kritike.....</i>	<i>28</i>
Përfundimi.....	30
Bibliografia e autorit.....	31
Literatura e përdorur.....	31

Bedri Dedja



(1930-2004)

*“Më i lumtur nga të gjithë do të jetë ai popull,
i cili më mirë se çdo gjë tjetër do të mësojë fëmijët e vet,
do të dijë të pasurojë mendimin dhe t’u japë drejtimin ndjenjave të tyre”.*

Hyrje

Objekti dhe motivimi i temës

Letërsia popullore dhe sistemi komunist ndikuan shumë në veprimtarinë letrare të Dedjes. Por me veprat e tij ai ka ndikuar në psikologjinë e fëmijëve, është munduar që të jetë mësues duke dhënë këshilla, por edhe duke i bërë që të shohin realitetin me sy.

Fëmijëve iu bënë thirrje që të jenë humanistë dhe që ata duhen të jenë e ardhmja e vendit, ai godet edhe zakonet e shoqërisë, martesën e vajzave në bazë të zakoneve kanunore. Me veprat e tij shkencore për fëmijë e zhvillon imagjinatën dhe fantazinë e tyre.

Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i veprimtarisë letrare të shkrimtarit të mirënjohur, Bedri Dedjes dhe kontributi i tij në letërsinë për fëmijë. Pas kësaj do të shtrohen edhe çështje të tjera që kanë ndikuar në temat dhe motivet e krijimtarisë së tij.

Me anë të kësaj teme do të synojmë të paraqesim disa analiza të veprave të autorit, siç janë përrallat, novelat, poemat, tregimet dhe romanet.

Metodologjia e punës

Bedri Dedja ka filluar të shkruaj që në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare dhe dy ditë para vdekjes kishte përfunduar veprën e tij që cilësohet si “Testamenti letrar e shpirtëror i autorit”.

Ishte figura qendrore e letërsisë për fëmijë, Dedja e pasuroi veprën e tij letrare duke sjellë elemente të reja në letërsinë shqipe. Për analizë të veprave të tij na kanë ardhur në ndihmë; metoda analizuuese, deskriptive dhe hulumtuese, që na mundëson që të nxjerrim në pah vlerat dhe rëndësinë e veprave të autorit.

Kapitulli i parë

1. Jeta dhe veprimtaria letrare e Bedri Dedjes

1.1 Jeta e autorit

Bedri Dedja, akademik dhe profesor në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë, ka qenë një personalitet shumëplanësh në krijimtarinë letrare shqiptare për të vegjlit dhe atë shkencore për të rriturit: poet e prozator, përrallëtar e dramaturg, tregimtar e publicist, novelist e romancier, përkthyes, gazetar e kritik, studiues i psikologjisë, pedagogjisë e historisë së arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, studiues e teoricient i historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë. Fitues i shumë çmimeve letrare, "Qytetar Nderi" i Beratit, mbajtës i "Çmimi i Republikës", "Urdhrit Naim Frashëri" dhe titullit "Mjeshtër i Madh".

Bedri Dedja është vlerësuar gjithashtu nga Qendra Ndërkombëtare e Biografive në Kembrixh, duke zënë vend në Vëllimin e XVI-të të biografive si autor i shquar i shekullit XX. Bedri Dedja ka lindur në Korçë më 20.11.1930. Shkollën fillore e kreu në Shkodër ndërsa gjimnazin e përfundoi në qytetin e Durrësit. Më pas studioi në Universitetin e Moskës dhe u diplomua shkëlqyeshëm në vitin 1953 në disiplinat e pedagogjisë, psikologjisë dhe njëkohësisht të letërsisë për fëmijë. Pas përfundimit të studimeve universitare, për 40 vjet ka qenë lektor dhe profesor titullar i lëndëve të psikologjisë dhe pedagogjisë në Universitetin e Tiranës dhe për një periudhë pesë vjeçare (1975-1980) edhe në Institutin e Lartë Pedagogjik të Elbasanit. Nga viti 1972 e deri sa u nda nga jeta më 13 prill 2004, ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Në vitin 1975 ai ka ushtruar edhe funksione drejtuese publike si drejtor i Institutit të Lartë Pedagogjik Tiranë, kryeredaktor i revistës "Fatosi" dhe gazetës "Mësuesi", drejtor i Drejtorisë së Botimeve Shkollore e drejtor i Institutit të Studimeve Pedagogjike në Ministrinë e Arsimit, zëvendësministër i Arsimit dhe Kulturës si dhe sekretar i Përgjithshëm Shkencor i Akademisë së Shkencave. Ka qenë anëtar i redaksisë së përgjithshme për hartimin e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (1985) si dhe bashkautor dhe redaktor përgjegjës i botimit të Akademisë së Shkencave dhe Ministrisë së Arsimit, Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar Vol. I (2003).¹

¹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Bedri_Dedja

1.2 Veprimtaria letrare e Bedri Dedjes

Krijuesi i dy kohëve

Dedja është krijues që jetoi në kohën e monizmit dhe idealizimit të tij. Dominimi i idealizimit të sistemit në art ishte i kushtëzuar në shoqërinë shqiptare të kohës, shkak i një ambienti të thekur politikisht, ku gjithë krijuesit afirmojnë dhe njëkohësisht indoktrinojnë me këtë frymë lexuesit, përmes veprave të tyre. Në veprat e kësaj kohe kemi plot ide të dala nga kjo ideologji aktuale dhe veprat që u krijuan në këtë kohë janë një reproduktim, një riprodhim i atij realiteti.²

Ishte nga shkrimtarët që pas rënies së komunizmit krijimtaria e tij letrare shënon një vlerë të caktuar, dhe kjo mund të quhet vlera të postkomunizmit. Dedja duket që bënë ndarjen e krijimtarisë së tij letrare, në atë të periudhës moniste dhe të kohës postkomuniste. Kjo ndarje e krijimtarisë bie në sy nga fryma e tij krijuese. Bazat tematike, stili dhe vlerat ideo-artistike janë elementet që shkrimtari Dedja i përdor për ndarjen e veprimtarisë së tij letrare.

Në moshën 15 vjeçare filloi të shkruaj dhe udhëhoqi gazetën *Flamurtari i vogël*. Ishte i njohur për studimin e tij rreth periodizimit të historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë. Cilësohet si themeluesi i teorisë së letërsisë për fëmijë. Disa nga studimet e tij për fushën e letërsisë për fëmijë janë: *Letërsia për fëmijë, Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë, Shkrime mbi letërsinë për fëmijë etj.*

Veprat dhe studimet e Bedri Dedjes kanë nivel të lartë shkencor, kanë frymë kombëtare dhe janë vepra moderne. Shërbejnë edhe sot në ngritjen profesionale, shkencore dhe psikologjike të mësuesve. Dedja u bë figurë qendrore e letërsisë për fëmijë, më shumë se dyzet libra për fëmijë në të gjitha llojet e gjinitë letrare, dhe botimet në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë. Po ashtu veprimtaria e Dedjes kishte suksese edhe jashtë kufijve shqiptarë, vepra “*Një udhëtim i rrezikshëm*” është botuar në shumë gjuhë dhe është në listën e nderit të Organizatës Ndërkombëtare të Letërsisë për fëmijë. Shumë vepra të autorit Dedja janë botuar në Sh.B.A, Francë, Rumani, Kinë, Rusi etj.

² Demiri-Frangu, Dije, “Letërsia për fëmijë” Prishtinë, Rozafa, 2013, fq. 166.

1.3 Veprat

I . Novela

- *Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit, 1954.*
- *Një udhëtim i rrezikshëm, 1961.*
- *Kërcënimi i thonjve kozmikë (fantastiko-shkencore), 1976.*
- *Përrallëmadhja (fantastiko-shkencore), 1998.*

II. Tregime e përralla

- *Kallëzimet e gjyshe Pastërtores, 1960.*
- *Kapiteni i shtrëngatës, 1970.*
- *Përralla popullore mbi kafshët, 1957.*
- *Përralla e tre vëllezërve, 1958.*
- *Bariu i vogël në mal të thatë, 1983.*
- *Përralla njëmbëdhjetëkatëshe, 1996.*
- *Republika e 1100 çudirave (përralla të zgjedhura), 1997.*

III. Romane

- *Kalamajtë e pallatit tim (vëllimi I më 1972, i dyti më 1979)*
- *Republika e 1100 çudirave, 1975.*
- *Nëpër korridoret e thella të Jonit, 1978.*
- *Metë partizani, 1981.*
- *Si u rrit një komisar, 1986.*
- *Alarmet e qytetit Sdikushit, 1989.*
- *Si katër fëmijë u bënë biznesmenë, 1996.*
- *Qyteti me tri kështjella, 1998.*
- *Presidenti i planetit të kuq, 2006.*

IV. Poema

- *Numrat, 1959*
- *Shkolla e pyllit, 1967.*
- *Artan borizani dhe çeta e tij, 1970.*
- *Patoku në plazh, 1976.*

V. Studime në fushën e letërsisë për fëmijë

- *Letërsia për fëmijë, tekst për shkollat pedagogjike, 1961.*
- *Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë, 1972.*
- *Shkrime mbi letërsinë për fëmijë, 1978.*

VI. Përkthime nga gjuha ruse

- *Lev Tolstoi: Tregime dhe përralla për fëmijë (1954), Robi i Kaukazit (1959)*
- *V. Majakovski: Për fëmijët (1954), Lexo, shëtit e fluturo (1958), Ç'është mirë e ç'është keq (1966)*
- *Nikolla Nosov: Tregime (1954), Aventurat e Dinpakut dhe të shokëve të tij (1957)*
- *Mark Tuen: Aventurat e Tom Sojerit (1955)*
- *A.S. Pushkin: Përralla e Peshkatarit dhe e Peshkut (1956)*
- *H.K. Andersen: Përralla (1956)*
- *Maksim Gorki: Jashka, Samovari (1957)*
- *Sharl Pero: Maçoku me çizme.*
- *Përralla ruse (1998 përshtatje e shqipërime nga 18 autorë) etj.*

Kapitulli i dytë

2. Përrallat fantastike të Bedri Dedjes

Shkrimtari Bedri Dedja i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe krijimit të përrallës origjinale, po ashtu edhe ritregimin e përrallave popullore.

Dedja është nga të parët shkrimtar, që theu kornizën e përrallës tradicionale me subjekte nga folklori. Shquhet për krijimin e përrallave ndryshe nga të tjerët, kishte mënyrën e vet të gjetjes së fabulës, të subjektit, të krijimit të personazheve. Në përrallat e tij vend të veçantë zë humori i cili është mjaft i kërkuar nga lexuesit e vegjël.

2.1. Përralla popullore mbi kafshët

Përralla popullore mbi kafshët është një vepër e vogël, por me rëndësi të madhe për fëmijët. Përrallat janë të dëgjura nga goja e popullit, dhe shkrimtari i ka përpunuar dhe i ka përmbledhur në këtë libër. Përrallat janë të lehta të lexohen, ato mbahen mend dhe secila sjellë nga një porosi të veçantë.

Përralla e parë “*Merimanga dhe brumbulli*”, merimanga e shfrytëzon mendjehetësinë e brumbullit dhe e lidh gjatë natës. Përralla ka një porosi mjaftë të rëndësishme për lexuesit e vegjël, sepse ata duhen të jenë të kujdesshëm, ku na dëshmon me vargun e fuqishëm shëmbëllyet më poshtë:

*“Unë di vetëm të lidh, kurse të zgjidh nuk di”.*³

Te përralla “*Lepuri dhe iriqi*” krijuesi Dedja na shfaqë një mësim të vlefshëm, sa edukativ, po aq psikologjikë, madje për të gjitha kategoritë e lexuesve, si zakonisht me shembujt bindës: “*dukja e jashtme nuk vlen, por vlen zemra*”. Po kështu nuk është vetëm

³ Dedja, Bedri, *Përralla popullore mbi kafshët*, Prishtinë, Rilindja, 1997, fq. 8.

në botën e kafshëve, por edhe tek njerëzit. Është e kot nëse njeriu ka një pamje të bukur, kur nuk ka një zemër të madhe.

Përralla ‘*Gomari dhe ujku*’ është mjaftë qesharake por edhe interesante dhe me një mësimdhënie. Lakmia e madhe e sjellë ujkun në vështirësi të papritura, ashtu sikurse edhe njerëzit që nga lakmia e madhe humbasin çdo arsye.

2.2. Republika e 1100 çudirave

Vepra *Republika e 1100 çudirave* përbëhet nga përralla të zgjedhura, të cilat kanë një lidhshmëri ndërmjet tyre të cilat janë të ndërtuara si formë romani, që u dedikohen fëmijëve. Dedja nuk e përfill mendimin e kritikës që romani është i vështirë të lexohet nga fëmijët, por thotë se fëmijët më leximin që i bën këtij romani, e mundën kritikën. Rrëfimet kanë baza popullore, autori kur i ritregon i krijon në një mënyrë mjaftë interesante.

Autori që në titull mundohet ta shpjegoj tregimin. Me disa fjali që përbëjnë titullin e tregimit, të cilat janë fjali shpjeguese e bëjnë më të lehtë kuptimin e tregimit për fëmijët. Dedja si pedagog e psikolog mendohej që në mënyrë sa më duhur të bënte kultivimin e ndjenjave pozitive tek fëmijët. Shkrimtari tek fëmijët mundohet që ta forcojë sa më shumë forcën e fëmijëve por më shumë forcën morale të tyre. Dedja ndryshe nga shkrimtarët e tjerë nëpër veprat e tij fut personazhe nga letërsia botërore si Pinokun ose Liza në botën e çudirave po ashtu edhe heronjtë amerikanë. Dedja mundohet që të krijoj një krahasim mes heronjve autorialë dhe atyre “*të huazuar*”.

2.3 Përralla njëmbëdhjetëkatëshe

Kritika e ka vlerësuar përmbledhjen *Përralla njëmbëdhjetëkatëshe*, si veprën më të arritur të autorit Dedja. Në këtë vepër autori shfaqë pjekurinë e tij artistike dhe profesionale. Rëndësi të madhe i kushton vlerave letrare dhe edukative.

Libri ka një strukturë të konceptuar në mënyrë origjinale. Çdo përrallë ka një fushë zhvillimi, ku ka ndërthurje të fabulave dhe zhvillim të subjektit, kemi një zhvillim të vrullshëm të botës. Pallati është vendi që i bashkon përrallat sepse të gjitha kanë tematika

të ndryshme po ashtu edhe organizon subjektin. Në këtë përmbledhje Dedja nuk ka qenë vetëm shkrimtar, por edhe profesor i psikologjisë ku vërehet mjaft qartë trajtimi i problemeve në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshëm.

Këto përralla kanë disa veçori të tjera:

Përrallat dallohen për temporitmin e lartë të zhvillimit. Personazhet duken sikur janë të elektrizuara, dhe çdo lëvizje është e studiuara nëpër mjedise të ndryshme si jashtëtokësorë, në gjysmëdritë etj. Në përralla kemi situata dramatike e me humor dhe që befasojnë fantazinë krijuese të autorit. *Historia e miut të fundit të botës* dhe *Historia e këpucëve të reja të mbretit* janë përralla që kanë vlera edukative.

Elemente të tjera janë toponomastika, emrat e njerëzve, neologjizmat e letrarizimet me efekte etj. Po ashtu autori tregohet i kujdesshme me lidhjen e situatave jetësore me fantastiken. Ajo që bie në sy në këto përralla është gjatësia e tyre, që shkon duke u zvogëluara në secilën përrallë.

Kapitulli i tretë

3. Novela

Njëri nga nismëtarët e novelës është edhe shkrimtari Bedri Dedja, me veprën “*Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit*”.

3.1 *Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit*

Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit është një novelë, e cila nga tematika dhe mënyra e subjektit bën pjesë në llojin e përrallës fantastike. Heroi i veprës është një fëmijë, i cili kalon nga bota reale, në botë përrallore ku Fatbardh Pikaloshi fillon me heroizmat e tij duke kaluar çdo pengesë që i del përpara edhe duke realizuar me sukses çdo heroizëm të tij. Fatbardhi është një fëmijë guximtar, besnik, me një zemër të madhe. Ngjarjen autori mundohet të tregoj në mënyrë gazmore, gjuha është e thjeshtë e afërt me atë popullore. Figurat mbizotëruese janë personifikimi dhe onomatopeja.

- *Krrrau , krrrau...po nga je ti, mor bir?*

- *Jam Fatbardh Pikaloshi nga Tirana...*

- *Krrrau, krrrau ...po nga je nisur, mor bir!*

- *Në botën e përrallave.*⁴

*Krrek! Ja, arritëm!- i tha Shqiponja krahëgjërë syshigjetë,- e shikon atë dritë aty poshtë??...*⁵

Autori me anë të kësaj novele mundohet që të krijoj ndërtimin e një shoqërie sa më punëtore duke goditur njerëzit parazitë, por edhe arritjen e lumturisë. Me fantazinë e tij

⁴ Dedja, Bedri, *Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit*, Prishtinë, Rilindja, 1980, fq. 16.

⁵ Dedja, Bedri, *Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit*, Prishtinë, Rilindja, 1980, fq. 18.

dhe me “*shkopit të fundit magjik*” ku autori e dërgon në botën e përrallave heroin e vogël. Në botën e përrallave Fatbardhi tregon zgjuarsinë e tij po ashtu edhe guximin e madh që e kishte, ai çdo herë ndihmohet nga kafshët e pyllit për të dal fitimtar, krijoi edhe “*Republikën Demokratike*”. Autori Dedja ëndrrën e përdor si mjet për të kaluar nga një plan në tjetrin, po ashtu në rrëfimet e tij e përdor realen dhe fantastiken. Heroi Fatbardh mendon se në këtë botë është e lehtë plotësimi i dëshirave, por kur ndodhet përballë situatave të vështira e kupton që bashkimi është mundësi më e mirë për të dal fitues. Krijimi i Republikës së kafshëve është një kryengritje kundrejt pushtetit, ku kafshët së bashku me Fatbardh Pikaloshin e rrëzojnë pushtetin, dhe Qenin Qimekuq e bëjnë kryetar. Fatbardhi në botën e tij reale përcjellët me nderime të larta.

*Fatbardhi i kish kryer gjithë ato heroizma, kish bërë gjithë ato të mira. Skish dyshim se tani e meritonte që Gishtua tija hapte me nderim portën e floringtë të botës së përrallave për të ardhur tek ne...*⁶

3.2 Një udhëtim i rrezikshëm

Edhe vepra *Një udhëtim i rrezikshëm* është një novelë-përrallë, në këtë novelë autori ndërton një fabul dinamike e me plot fantazi.

Personazhet kryesore janë: Kokëdruthi, Kokëtaça dhe Kokëfirifiu, të cilët largohen fshehurazi nga vendlindja dhe ikin në Qytetin e Qejfit .

...Kokëdruth, o bir,
ku e le mamanë
bashkë me motrën dhe vëllanë?
Ktheu, Kokëdruth,
ktheu në shtëpi,
mami ty të ka
djalë si flori....⁷

⁶ Dedja, Bedri, Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit, Prishtinë, Rilindja, 1980, fq. 64.

Tek kjo pjesë kemi vajtimin e nënës së Kokëdruthit kemi përdorimin e figurave siç janë; anafora, enumeracion, epiteti, dhe të gjithë strofën e përshkon rima dhe ritmi.

Dedja me anë të kësaj novele kritikon veset e fëmijëve. E gjithë ngjarja zhvillohet rreth Kokëfirifit i cili është edhe figura qendrore e novelës. Kokëfirifit është një fëmijë i zakonshëm, por shoqëria që krijon me Kokëtapën dhe Kokëdruthin, dhe dëshira të jetë si ata i sjellë shumë probleme.

Kokëdruthi dhe Kokëtapë janë dy fëmijë problematika, të cilët nuk kanë respekt për asgjë, dhe shkollën që është vend i dijes ata e përbuzin, Dedja tek këta fëmijë paraqet anë e errtë të shoqërisë. Ata vihen në shërbim të keqbërësve dhe duke e dëmtuar atdheun e tyre. Një figurë tjetër negative është ajo e usta Ipaudhit i cili është një njeri i lig i cili punon kundër vendit të tij, edhe Kokëdruthin e Kokëtapën janë fëmijë të llastuar dhe lehtë mashtrohen. Autori mundohet të godet luftën e klasave, dhe që t'i vijë fundi armiqve të socializmit që po shkatërrojnë vendin dhe shoqërinë.

Vepra ka një stil tërheqës, dialogu është i shkathët, vëmendje tërheq përdorimi i onomastikes, ka aventura të shumta që e bëjnë edhe me tërheqës për lexuesin, po ashtu autori ka përdorur edhe disa fjalë të huaja siç janë: prezent, pauza, rezultat etj. Vepra *Një udhëtim i rrezikshëm* ngjalli debate në kritikën tonë letrare. Novela u akuzua për dobësi artistike e ideore, sikur i konceptonte keq “*kontradiktat antagonistë e joantagonistë*” etj

⁷ Dedja, Bedri, *Një udhëtim i rrezikshëm*, Prishtinë, Rilindja, 1972, fq. 29.

Poemat: *Shkolla e pyllit* dhe *Artan borizani dhe çeta e tij*

3.3 *Shkolla e pyllit*

Bedri Dedja shkroi poemën *Shkolla e pyllit*. Kjo poemë i përket gjinisë epiko-lirike. Nëpërmjet të menduarit autori paraqet botën në kuptimin figurativ, ku ndjenjat shndërrohen në përfytyrime dhe imazhe artistike. Në brendi të poemës ka zgjedhje dhe përdorim të figurshëm të fjalëve. Përmes këtij lirizmi shprehet shtjellimi i ndjenjave, përjetimi. Poema shquhet me zgjedhjen e fjalëve, rimave, vargjeve, intonacionit. Përmes kësaj poeme autori nxit imagjinatën e fëmijëve dhe rëndësinë e të mësuarit duke gërshetuar karakteristikat dhe cilësitë e njerëzve në atë të kafshëve. Mjedisi është pylli, ideja është shkolla si objekt qendror i poemës dhe mesazhi është dija.

Kjo poemë ka një fabul të rrjedhshme. Përbëhet nga 18 strofa me vargje të ndryshme. Strofa e parë përbëhet nga 6-të vargje me rimë të njëpasnjëshme ABAB. E përshkojnë këto figura: polisindetit (*shtimi i lidhëzave*), anafora në vargun e tretë dhe të katërt me fjalën (*plot*) që është përsëritja në fillim të vargut, enumeracioni (*plot me ferra, plot me drurë, plot kërpudha edhe gurë*).

Strofa e dytë përbëhet nga 30-të vargje, me rimë të përzier. Figurat stilistike: onomatopeja (*rap e tap, e rap e tap*) dhe një ritëm për gjatë strofës, alegoria etj.

Strofa e tretë përbëhet nga 16-të vargje. Figurat stilistike: personifikimi, enumeracioni, anafora.

Strofa e katërt përbëhet nga 16-të vargje. Figurat stilistike alegoria, krahasimi.

Strofa e pestë përbëhet nga dy vargje (*dystike*) me rimë AB dhe enumeracion (*aritmetika, vizatimi*).

Strofa e gjashtë përbëhet nga 18-të vargje. Figurat stilistike: përsëritja, personifikim, portretizimi, alegoria, simboli etj.

Strofa e shtatë përbëhet nga 12-të vargje, personifikimi dhe portretizimi.

Kjo poemë ka qëndrim ideo-estetik përmes lirizmit dhe i përket nivelit ideo-simbolik. Përshkrimi- është paraqitje e pamjeve, mjedisit (*pyllit*) të natyrës së kafshëve.

Portretizimi- është përshkrimi i cilësive njerëzore dhe i karakteristikave duke iu veshur kafshëve. Ideja është që fëmijëve t'u tregoj rëndësinë e shkollës, dhe t'u a bëj më tërheqëse mësimin përmes kafshëve. Subjekti: shkrimtari zbulon karakteret e personazheve në veprim, duke i paraqitur në marrëdhënie të caktuara me vetën dhe të tjerët.

3.4 Artan borizani dhe çeta e tij

Artan borizani dhe çeta e tij është një poemë realiste e botuar në vitin (1970). Shumica e poemave të botuar në atë kohë ishin më tepër përralla fantastike me kafshë të personifikuara. Autori në këtë poemë rrëfen veprimtarinë e disa fëmijëve të vegjël, të një pallati që ndodhej në kryeqytet. Fëmijët vullnetarë krijuan një çetë .Ata mundohen që të luftojnë kundër çdo gjëje, që bëhet pengesë për një edukim të shëndoshë të tyre.

Poema ndërtohet si një varg ngjarjesh brenda linjës kryesore të subjektit. Fëmijët janë heronjtë e poemës. Në këtë poemë autori mundohet të paraqet anët pozitive të fëmijëve. Fryma e solidaritetit midis njerëzve është e pranishme në të gjithë poemën. Përsëritja është njëri nga mjete stilistike të përrallave popullore që autori e ka përdorur, ka raste që përsërit një ide, një situatë etj.

Poema *Artan borizani dhe çeta e tij* është ca e ideologjizuar. Kjo poemë u bë jehonë e problemeve të kohës, luftës kundër ideologjisë borgjeze, dhe gjendjen e punëtorëve, që ishin nën kontrollin e ish-partisë së punës. Që ushtronte kontroll në çdo sferë të jetës sociale.

3.5 Tregimtari Bedri Dedja

Prof. Bedri Dedja, ishte edhe krijues i tregimeve po ashtu edhe studiues i tyre. Në një studim mbi tregimin mundohet të skicojë veçoritë e individualitetit të tyre. Dedja kalon me lehtësi nga përralla në tregimin e zakonshëm dhe, anasjelltas, nga tregimi në përrallë.

Mund të përmendim përmbledhjen *Kapiteni i shtrëngatës*. Në qendër të këtyre tregimeve janë shembujt pozitivë të njerëzve tanë. Autori nëpërmjet këtyre tregimeve mundohet që fëmijët t'i edukojë dhe që të jenë sa më të dashur me njëri-tjetrin.

3.6 Kallëzimet e gjyshe Pastërtores

Kallëzimet e gjyshe Pastërtores është një vepër me tregime për fëmijët e vegjël. Janë gjashtë krijime ku të gjitha kanë një temë të përbashkët e ajo është pastërtia. Na paraqitet dashuria e vajzave të vogla ndaj gjyshërve të tyre. Personazhi më simpatik është gjyshja Pastërtorja, dhe rrëfimet e saja që janë përralla të bukura. Vepra shquhet për informacione që ju sjell lexuesve të vegjël, për rëndësinë e higjienës personale.

Ligjërimi bëhet në dy rrafshë: fantastik e realist. Kemi bisedimin që bëjnë furça e dhëmbëve, pasta dhe sapunin, por që nuk bisedojnë me njerëzit, përpos shamisë së mëndafshit që flet e çirret me Enon.

Në këto rrëfime kemi përdorimin e onomatopesë.

Trak-e-trak, trak-e-trak, me kuaj i ranë botës anëmbanë.

.. i binte daulles dum-dum-dum...⁸

Shaminë e mëndafshit është një zonjë mendjemadhe, që nuk bënë asgjë vetëm dëshiron të shëtisë botën, ndërsa shamia e pëlhurës është me të gjitha tiparet ndryshe nga shamia e mëndafshit, ajo është një vajzë shumë punëtorë dhe modeste. Tregimet ndahen

⁸ Bishqemi, Astrit, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë, Elbasan, Sejko, 2001, fq.376.

në pjesë të vogla, lidhen me njëra-tjetrën dhe kuptohen mjaft lehtë. Në çdo tregimi autori përdorë fabulën, që tregimet të jenë sa me tërheqës për lexuesit e vegjël. Për shembull, te kallëzimi i parë, *Aventurat e furçës së dhëmbëve, Pastës së dhëmbëve dhe Sapunit*, është një grua që i blen këto objekte në një parfumeri. Gjërat në çantë fillojnë të bisedojnë së bashku.

Këto rrëfime shquhen për fantazinë, humorin dhe gjetjen e së bukurës por edhe përdorimin e stilit të përrallës: *Na ishin njëherë tre fëmijë kopshti*. Autori me gjuhën e tij të pastër bënë përpjekje që ta pasurojë fjalorin e fëmijëve me fjalë të reja. Por autori ka përdorur edhe disa fjalë të cilat janë të vështira për lexuesit e vegjël, si; *detachment, shëmbëllente etj*, e sidomos barbarizmat; *rehat, u rehatua, sehir, peshqesh, muhabet etj*.

Autori i përfundon rrëfimet më një këshillë për fëmijët; *...Shikoni me kujdes se mos keni harruar ndonjë kopsë të zbërthyer? Mos keni harruar dhëmbët pa larë, këpucët pa lustruar e thonjtë pa prerë? Shikoni dhe një herë sepse kështu nuk do t'ju qeshë njeri dhe gjyshe Pastërtorja do të kënaqet shumë.*⁹

Dedja në vitin 1997 e botoi të ripunuar këtë vëllim në përmbledhjen *Republika e një mijë e njëqind çudirave*. Disa ndryshime ka bërë tek *Historia e plakut pasanik, thonjve dhe zgjuarsisë së farkëtarit zhelan*. Ndryshimi që ka bërë është që nuk e përdor me antipatinë ndaj personave të pasur dhe të fesë.

⁹ Bishqemi, Astrit, *Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë*, Elbasan, Sejko, 2001, fq.377.

Kapitulli i katërt

4. Romanet e Dedjes

Autori Dedja shquhet për një kulturë letrare dhe teorike , gjatë monizmit në Shqipëri nuk e fshehu tendencën aktuale të kohës (*romani Kalamajt e pallatit tim*), me kapërcimin ideologjik që bën, unifikon kriteret letrare me ato pedagogjike dhe krijon një letërsi të veçantë gjatë manifestimit të kësaj lirie krijuese, duke u bërë edhe krijuesi i parë i romanit fantastiko - shkencor.

4.1 *Kalamajtë e pallatit tim*

Romani *Kalamajtë e pallatit tim* trajton jetën e fëmijëve, por edhe pozitën e femrës shqiptare në shoqëri, duke u theksuar prapambeturin e femrës shqiptare. Prindërit dhe mësuesit nëpërmjet kësaj vepre mësojnë se çfarë metoda e punë këmbëngulëse duhet bërë për edukimin e fëmijëve. Përveç vlerave ideo-estetike romani ka edhe vlera pedagogjike. Autori Dedja në këtë vepër ka krijuar një galeri tipash e personazhesh të ndryshëm, siç janë komisari, kufitari, komandanti etj. Ngjarjet që ndodhin shërbejnë për zbulimin e tipareve të personazheve, janë ata që dëshirojnë të luftojnë kundër çdo gjejë që është e padrejtë. Genti është heroi kryesor, ai është fëmijë dinamik. Ngre zërin së nënat lodhen, kurse baballarët rrinë me orë nëpër kafene.

Autori godet fuqishëm martesat e parakohshme të vajzave sipas zakoneve kanunore, dhe ngre zërin për emancipimin e femrës. Kemi rastin e Miroshe e cila është viktimë e prindërve të saj fanatikë. Këtë pjesë të romanit zbulohen edhe tipat e atyre që “*mbajnë fjalime të zjarrta në mbledhje për mbrojtjen e çupave dhe që në shtëpi ngrinin shkopin si të tërbuar kundër tyre*”.¹⁰

¹⁰ Dedja, Bedri, *Kalamajt e pallatit tim*, Prishtinë, 2003, fq. 131.

Romani ka harmoni kompozicionale, të cilën e krijojnë ndarjet në kapituj e nënkapituj, si dhe inkorporimi i një ditari përmes të cilit autori bën një thyerje strukturale të romanit. Vepra shquhet për përdorimin e gjuhës së pastër nga ana e autorit dhe përpjekjet e Dedjes për pasurimin e fjalorit të fëmijëve me fjalë të reja. Autori vë në lëvizje mendjen dhe imagjinatën e fëmijëve përmes situatave të ndryshme. Vepra krahas frymës së saj ideore bart edhe vlera që shpërndahen përmes personazheve të ndërtuara si individualitete. E gjithë vepra përfundon me një epilog.

4.2 *Kacimicrri rreth globit*

Romani *Kacimicrri rreth globit* është i ndërtuar mbi figurën e letërsisë popullore gjithashtu edhe heroi kryesor. Tek ky roman kemi kombinimin e letërsisë gojore me shkencën, si p.sh raketa element shkencor ku kundruall Gishtoja është personazh i letërsisë orale. Me anë të raketës heroi ynë Gishtoja përshkruan të gjithë globin, duke i mundësuar edhe një fluturim të tillë edhe mendjes e fantazisë së fëmijës. Me anë të fluturimit Gishtoja, heroi i romanit bën takime të ndryshme, këto takime shërbejnë që të ndërtohet struktura e veprës krahas subjektit. Takimet me popuj të ndryshëm ndikojnë në thyerjen e kufirit shqiptar i cili ishte i izoluar.

Romani *Kacimicrri rreth globit* ka rëndësi të madhe për letërsinë shqipe për fëmijë, për arsye të hapësirës së gjerë poetike e gjeografike që ka. Vepra të rrëmben me gjuhën e saj, me stilin gazmor, ka larmi formash letrare. Kapitujt janë ndërtuar si rrëfenja, tregime, por edhe si përralla.

Autori godet shoqërinë shqiptare ku edhe kërkon ndihmë edhe nga zoti që të vetëdijesohen:

O Zot, O Perëndi! M'i fal mëkatet, ndihmoje at Shqipëri!

Se nuk kanë faj shqiptarët, po kanë kokat e shqiptarëve!

Ndihmoji ata se po vuajnë...ja, ne i hapëm përsëri të falen

për ty, o Zot, o Perëndi.¹¹

¹¹ Dedja, Bedri, *Kacimicrri rreth globit*, Tiranë, Uegen, 2002, fq.78.

Nëntitujt janë shumë interesant dhe e bëjnë lexuesin edhe me kurioz për zhvillimin e ngjarjes si p.sh. *Ivashka budallai i xhaxhi Gorkit tani ka ndërruar emër dhe quhet Ivashka i mençur*.¹² Me armën e humorit e të satirës autori kritikon e godet shumë dukuri negative të vendit tonë në vitet e tranzicionit demokratik: *Ti mos u thuaj atyre se Tirana është plot e përplot me plehra....Se tani del më shumë tim nga djegia e plehrave se sa nga oxhaqet e fabrikave dhe uzinave*,¹³ kështu e këshillon autori Kacimicrin para se të niset nëpër botë. Autori në këtë roman përrallen e transformon tërësisht por duke i ruajtur karakterin trillues dhe tipin e komunikimit përrallor. Brenda universit të përrallës autori inkorporon forma moderne të jetës dhe personazhet e romanit janë bashkëkohorë. Tek Dedja letërsia doemos se funksionon pos si art edhe si një pedagogji në vete, duke kompletuar tendencën artistike.

4.3 Qyteti me tri kështjella

Romani *Qyteti me tri kështjella* i takon kohës postkomuniste, pikërisht kohës së tranzicionit në Shqipëri. Ngjarjet në roman zhvillohen gjatë viteve të 80-ta, përkatësisht në qytetin e Elbasanit .

Personazhet e veprës, siç vëren studiuesi Prof. Agim Deva, janë pasqyrim real i kohës dhe përfaqësues të një klime kafkiane, ku njerëzit janë të lirë por edhe shumëfish të robëruar , me një ombrellë të zeze të politikës mbi kokë, e me fate të ngatërruara rëndë në një rrjetë të merimangës misterioze....¹⁴

Tek ky roman kemi etjen për karrierë , të cilët tentojnë të ngrihen në poste edhe duke i shkelur njerëzit e ndershëm. Shembulli i Kolës i cili është një kriminel i ndyrë i cili bënë çdo gjë për të zënë një post në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Me kërcënimet dhe shpifjet e tij ai mundohet të njollos edhe njerëzit më të veçantë .

Po ashtu kemi edhe trajtimin e pasojave të luftës së klasave. Kola shfrytëzon edhe rastet tepër të rënda, ku nxit një fëmijë që të marr hak, që ta arrestojë e të këtë suksese në

¹² Dedja, Bedri, Kacimicri rreth globit, Tiranë, Uegen, 2002, fq.28.

¹³ Dedja, Bedri, Kacimicri rreth globit, Tiranë, Uegen, 2002, fq.94.

¹⁴ Bishqemi, Astrit, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë , Elbasan, Sejko,2001, fq 745.

detyrë, duke e infektuar një djalë të ri me mendimin e hakmarrjes dhe të vrasjes.

Romani *Qyteti me tri kështjella* shquhet përthurjen e kompozicionit dhe të stilit. Ligjërimi i romanit bëhet në vetën e parë nga ana e Gjergjit. Kjo gjë nxjerr në pah botën shpirtërore të fëmijëve.

Titulli *Qyteti i tri kështjellave* ka të bëjë me qytetin Elbasanit në kështjellat e *Skampes*, industriale-Kombinatit Metalurgjik, si edhe atë natyrore malore - Gjinarin dhe Malin e Bukanikut, në këto mjedise kemi zhvillimin e ngjarjeve të romanit të cilat vende autori i njeh shumë mirë. Personazhet kryesore janë: Gjergji e Martini të cilët janë shok, janë ata që tregojnë edhe anët pozitive të shoqërisë shqiptare.

Dedja mendimin e vesh me petk artistik, po ashtu përdor edhe krahasime dhe metafora” të intelektualizuara” në gojën e personazhit fëmijë, Gjergjit;

-Na u bë mendja flokë zezaku

*...ne u zgjuam, duke dëgjuar jo një rapsodi për piano dhe orkestër në radio apo në skenë, po një rapsodi për qen dhe orkestër qensh në natyrë...*¹⁵

Në romanin *Qyteti me tri kështjella* realiteti i kohës nuk paraqitet, në mënyrë të drejtpërdrejtë pasqyrohet nëpërmjet dialogut të personazheve, por edhe përdorimin e shprehjeve frazeologjike.

Në studimin që i bën krijuesi për të vegjël, Agim Deva, thekson se “*Bedri Dedja është mjeshtër i madh i të rrëfyerit artistik, i gërshetimit kompozicional të situatave subjektore, i gdhendjes së karaktereve të personazheve, i tipizimit dhe individualizimit të tyre, i kombinimeve të suksesshme episodike, i strukturimit të përgjithshëm të veprës.*¹⁶

¹⁵ Bishqemi, Astrit, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë, Elbasan, Sejko, 2001, fq. 750.

¹⁶ Bishqemi, Astrit, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë, Elbasan, Sejko, 2001, fq. 750.

4.4 *Presidenti i Planetit të Kuq*

Librin *Presidenti i Planetit të Kuq* të shkrimtarit Bedri Dedja, është përkthyer në gjuhën gjermane dhe italiane, dhe përkthimi i tij ka përfunduar edhe në gjuhën rumune. Kjo vepër është cilësuar tashmë nga lexuesit shqiptarë dhe të huaj si një kryevepër e letërsisë ndërkombëtare për fëmijë.

“Presidenti i planetit të kuq” nga kritika letrare është cilësuar si “Testamenti letrar e shpirtëror i autorit”. Romani fantastiko-shkencor është ndarë në 40 kapituj dhe shoqërohet me ilustrime interesante, që ngacmojnë imagjinatën e fëmijëve gjatë leximit. Ndërsa subjekti mjaft interesant ka një vijueshmëri lineare të ngjarjeve. Historia fillon me frazën e hasur shumë shpesh në përrallat e vjetra: “*Na ishte një here...*”

Kjo fjali, së bashku me personazhet që vijnë nga veprat e mëparshme të autorit (“Fatbardh Pikaloshi” dhe “Një Udhëtim i Rrezikshëm”), të lënë përshtypjen se kjo histori buron nga thellësitë e shekujve, së bashku me misteret e tyre. Gjuha e shkrimtarit është e thjeshtë, e qartë dhe duket sikur kumbon jehonën e tyre. Kjo histori është një histori sa e vjetër, aq edhe e re. Ngjarjet duket sikur vijnë nga lashtësia, mbushur me mistere dhe vendosen në kozmos në bashkëkohësi. Lufta mes së mirës e së keqes është një luftë e gjerë që kapërcen shekujt e që përsëritet e ripërtërihet vazhdimisht.

Kjo temë madhore, në qendër të veprës vjen e pozicionuar në një shekull të ri e në një dimension të ri. Brezat evoluojnë e bashkë me ta, edhe mjetet e argëtimit. Për t’iu përshtatur këtij zhvillimi shumë dimensional, Bedri Dedja ka sjellë një libër sa bashkëkohës, aq edhe vizionar për të ardhmen. Ai duket se e njeh në thellësi botën e fëmijëve dhe kërkesat e tyre, mbasi në këtë roman ai ka ndërthuru dijen, fantazinë, shkencën, ëndrrat dhe edukimin.

Për ta paraqitur më konkretisht ndërtimin e kësaj vepre madhore, atë mund ta ndajmë në tre pika kryesore:

Së pari, pika kryesor ku mbështetet ky libër është fantazia, që arrin majat më të larta, duke i pozicionuar të gjitha ngjarjet dhe temat më të mprehta aktuale, në kozmos. Fantazia është shumë e rëndësishme dhe e shëndetshme për botën e fëmijëve, prandaj

shkrimtari Bedri Dedja, nëpërmjet saj e ka pasuruar veprën e tij të fundit me shumë imagjinatë dhe ide kreative.

Së dyti, pika tjetër është dija. Ky libër shërben edhe si një libër shkollor, sepse u transmeton fëmijëve dije shkencore e shumë të vërteta për galaktikën tonë. Ata mund të mësojnë shumë mirë duke u argëtuar nëpërmjet këtij libri, Bedri Dedja është ideal për të mësuar dhe argëtuar njëkohësisht lexuesit e vegjël.

Së treti është edukimi. Nëpërmjet këtij libri, Bedri Dedja do të mbjellë farën e së mirës në ndërgjegjen e çdo lexuesi. Shkrimtari transmeton në mënyrë të natyrshme frymën pozitive për kontribuar në të mirë të vendit.

Presidenti i planetit të kuq është një roman që favorizon komunikimin e personazheve dhe të vlerave, duke u bërë i veçantë në këtë aspekt. Bota fikzionale e autorit është shumë e pasur dhe krejt spontane. Dedja në këtë roman më mirë se në secilin roman tjetër e kupton se fëmijëria është e bukur vetëm kur ushqehet me dashuri e komunikim të pafund. Romani *Presidenti i planetit të kuq*, dallon dukshëm nga të tjerët, sepse: “*Në të ndërthuren probleme të mprehta aktuale si diktatura dhe demokracia, lufta dhe paqja, terrorizmi dhe Evropa e bashkuar, roli i shkencës dhe i informacionit bashkëkohor në edukimin e drejtë të fëmijëve të sotëm.*¹⁷

¹⁷ Dedja, Bedri, *Presidenti i Planetit të kuq*, Prishtinë, 2008, fq.7.

Kapitulli i pestë

5. Studimi për periodizimin e historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë

Një studim të plotë dhe me argumente për problemet e periodizimit e ka bërë edhe akademiku Bedri Dedja. Studimin e fillon me këto kritere;

Së pari, kërkon të merren parasysh kushtet ekonomiko-shoqërore, në të cilat lindi dhe u zhvillua letërsia gojore apo letërsia shkollore dhe artistike për fëmijë.

Së dyti, ka parasysh të theksojë ndryshimin që është vërtetuar në jetën shoqërore politike, pra merr parasysh dialektikën e zhvillimit.

Së treti, nuk lë mënjanë specifikën e procesit letrar. Pra, periodizimin e historisë së letërsisë për fëmijë nuk e merr mekanikisht nga historia e letërsisë së përgjithshme artistike shqiptare. Sepse, sipas studiuesit, letërsia për fëmijë ka specifikën e vet, që lidhet me etapat e evolucionit të leximit për fëmijë, si dhe me zhvillimin e arsimit e të shkollës brenda kuadrit të së cilës ajo lindi.

Prof. Dedja e ndan në katër periudha historinë e letërsisë shqiptare për fëmijë. Të gjitha kanë tiparet e tyre të veçanta por edhe të përbashkëta.

Periudhën e parë e përbënë krijimtaria gojore e cila është burimi i letërsisë për fëmijë. Si proces i vetëm, kjo letërsi ka zgjatur deri nga fundi i shekullit XVI, kur edhe lindi letërsia shkollore për fëmijët.

Dedja krijimtarinë gojore e sheh në tri aspekte themelore;

a) letërsia e krijuar në shekuj posaçërisht dhe për të vegjlit, si përmbajtje e gjini, e cila ka kryer edhe funksionin edukues e arsimor kur mungonte shkolla; b) si letërsi e përdorur për nevoja shkollore që kur u formua shkolla shqipe; c) në aspektin teorik të krijimtarisë gojore për fëmijë, lidhur me veçoritë stilistike dhe pedagogjike të folklorit për fëmijë, që e dallojnë atë nga folklori i përgjithshëm.

Edhe sot letërsia gojore është burimi mbi të cilën ndërtohet letërsia e shkruar dhe artistike për fëmijë.

Periudhën e dytë e përbëjnë veprat didaktiko-mësimore, që kanë qenë burim i zhvillimit të letërsisë për fëmijë. Këtë periudhë studiuesi e lidh, si fillim, me katekizmin e

Lekë Matrangës për mësimin fetar të arbëreshëve, të rritur e të vegjël, më 1592, me lindjen dhe zhvillimin e letërsisë fetare didaskalike të veriut të Shqipërisë. Kjo letërsi pati karakter dhe pikëpamje të ndryshme, për shkak se u zhvillua, në kushtet e pushtimit të rëndë feudal turk.

Periudhën e tretë e përbënë letërsia artistike për fëmijë e periudhës së Rilindjes, si dhe e kohës së mëvonshme gjer në pushtimin fashist të Shqipërisë. Kjo periudhë lidhet ngushtë me idealet për përhapjen e gjuhës shqipe, po ashtu edhe hapjen e shkollave shqipe.

Në këtë periudhë letërsia artistike për fëmijë kishte karakterin e saj didaktik, ku krijimet ishin moralizues dhe kishin nuanca pedagogjike. Kjo periudhë e letërsisë ka patur ndikim për krijimin e tipareve realiste.

Periudhën e katërt e përbënë letërsia e realizmit socialist për fëmijë. Në këtë periudhë kemi krijimet e para të letërsisë për fëmijë, në vitet e luftës Antifashiste dhe të periudhës së pasqilimit.

Prof. Bedri Dedja studimit të tij, për problemin e periodizimit të letërsisë shqiptare për fëmijë e ka ripunuar në vitet e demokracisë duke ju shmangur kriterit politizues. Letërsia moderne shqiptare për fëmijë fillon nga fundi i viteve të '20 dhe në fillimin e viteve '30, kjo letërsi kaloi nga Romantizmi i Rilindjes në realizëm.

Kemi katër argumente për këtë çështje: Gjatë viteve të '20 dhe '30 kemi tendencën për shkrime realiste në letërsinë për fëmijë., ku ishin përpjekjet që të shfaqen hallet dhe jeta reale në Shqipëri.

Periodizimi i ri i akademikut Bedri Dedja është ky;¹⁸

1. Burimet e letërsisë shqiptare për fëmijë, folklori për të vegjlit.
2. Letërsia e shkruar shqiptare për fëmijë, didaktike-fetare, shekujt XVI-XVIII.
3. Zanafilla dhe zhvillimi i letërsisë artistike për të vegjël, shekulli XVIII(fundi), shekulli XIX gjer në vitet '20-'30 të shekullit XX.
4. Letërsia moderne shqiptare për fëmijë , vitet'20-'30 të shekullit XX .

Prof. Bedri Dedja mendon se kjo periudhë e fundit ka dy faza të zhvillimit të saj;

a). vitet '30.

b). gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

¹⁸ Bishqemi, Astrit, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë , Elbasan, Sejko,2001, fq.21.

5.1 Mendime kritike

Alfred Moisiu, ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë

Bedri Dedja ishte njëri nga përfaqësuesit më të denjë të kulturës shqiptare, Akademisë së shkencave, studiuesve në fushën e psikologjisë e pedagogjisë, Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, themeluesi i letërsisë shqiptare për fëmijë, Miku i Madh i fëmijëve, Humanisti shumëdimensional, i cili deri në ditët e fundit nuk reshti pa dhënë kontributin e çmuar për të sotmen e për të ardhmen e tyre. Vepra e tij poliedrike, shkencore dhe letrare do të jetojë për brezat e ardhshëm si një vlerë e madhe e kulturës sonë Kombëtare.¹⁹

Katerina Xukaro publiciste në RAI-Itali

Bedri Dedja kërkon të thotë se shpëtimi i shoqërisë sonë nga rrënimi dhe dekadencia nuk qëndron në kënetën e bindjeve sociale, të cilave u nënshtrohen të rriturit, po është te fëmijët, te fantazia e tyre dhe te aftësia e tyre për të besuar tek e pamundura, duke shndërruar kështu çdo përrallë të bukur në realitet.²⁰

Akademik Rexhep Qosja

...Psikolog, pedagog, historian i arsimit dhe i pedagogjisë, kulturolog, mendimtar erudit, shkrimtar i shquar për fëmijë, një shembull i rendimenti të lartë në punë: me të drejtë Bedri Dedja konsiderohet si dekan i letërsisë së sotme shqiptare për fëmijë. Në këtë fushë ai na shfaqet tejte i gjithanshëm – krijues, teoricien cilësor, kritik, historian. Hartues i mbi 60 veprave letrare, midis të cilave shquhen “Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit”, “Një udhëtim i rrezikshëm”, “Kalamajtë e pallatit tim”, “Republika e 1100 çudirave”, etj. Në Shqipëri Bedriu është një figurë popullore, por atë e njohin mirë edhe jashtë truallit amë, kudo që ka shqiptarë e në vende të tjera.

¹⁹ . http://ëëë.zemrashqiptare.net/neës/id_7748/rp_0/act_print/rf_1/Printo.html

²⁰ Bedri Dedja ,në kujtesën tonë..., Tiranë, 2010, fq.316.

Me kthjelltësi të rrallë mendimi, me një të folur të qartë e të shtruar, të rrjedhshëm e të këndshëm, shquhej në komunikimin me të gjithë, që nga kolegët e deri tek lexuesit e vegjël, fëmijët.²¹

Agim Deva

...Bedri Dedja u bë prijatar në pavarësimin e shkencës psikologjike shqiptare. Krijues si ai janë njëkohësisht edhe dëshmitarë të asaj pikëpamjeje, sipas së cilës, të menduarit krijues në shkencë dhe në art kanë pikëtakim dhe, në kushte të veçanta, shfaqen si në njërin, ashtu edhe në lëmin tjetër krijues.²²

²¹ http://ëëë.zemrashqiptare.net/neës/id_7748/rp_0/act_print/rf_1/Printo.html

²² http://ëëë.zemrashqiptare.net/neës/id_7748/rp_0/act_print/rf_1/Printo.html

Përfundimi

Bedri Dedja shquhet si një krijues shumëplanësh dhe studiues, i cili me veprat e tij e pasuroi mjaft letërsinë shqiptare për fëmijë. Ishte nga të parët studiues që kishte bërë studime, për periodizimin e historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë. Shquhet si shkrimtari, që e theu kornizën e përrallës tradicionale me subjekt nga folklori, por edhe për mënyrë e gjetjes së fabulës, subjektit, dhe krijimin e personazheve.

Dedja po ashtu në veprat e tij përdor fantazinë e cila ndikon mjaft në psikologjinë e fëmijëve, autori në krijimet e veta tregohet i kujdesshëm në kapjen e çështjeve jetësore që prekin jetën e fëmijëve rëndësi iu jep shkollës dhe edukimit të fëmijëve. Ishte shumë kritikues ndaj pushtetit të cilin e cilësoje si kancer të popullit, por edhe ndaj shoqërisë. Në veprat e tij rëndësi i kushton emancipimit të femrës shqiptare. Të gjitha veprat dhe studimet e Bedri Dedjes, kanë nivele të larta shkencore dhe janë në ndikimin e frymës kombëtare, cilësohet si figura qendrore e letërsisë për fëmijë. Vend të rëndësishëm në veprat e autorit zë humori dhe satira ku nëpërmjet tyre autori kritikon shqiptaret dhe shoqërinë tonë.

Në krijimtarinë letrare të shkrimtarit Dedja, vend të rëndësishëm zë edhe romanin. Tek romanet e tij kemi përdorimin e gjuhës së pastër, por edhe përpjekjet e autorit që ta pasuroj gjuhën shqipe me fjalë të reja. Gjithashtu në veprat e autorit zë një vend të rëndësishëm edhe veprat fantastiko-shkencore, zhanër ky i parapëlqyer nga Bedri Dedja. Vepra e fundit “Presidenti i Planetit të Kuq”, është një kryqëzim origjinal midis romanit përrallë dhe fantastiko-shkencor. Edhe romani i fundit shënon një hap të mëtejshëm në krijimtarinë për fëmijë dhe njëkohësisht ruan vetitë më të mira të romaneve të tij të mëparshëm si dhe ngre në një nivel më të ri letërsinë shqiptare për fëmijë të shek. XXI.

Bibliografia e autorit

1. Dedja, Bedri, “Përralla popullore mbi kafshët”, Prishtinë, Rilindja, 1997.
2. Dedja, Bedri, “Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit”, Prishtinë, Rilindja, 1980.
3. Dedja, Bedri, “Kacimicrri rreth globi”t, Tiranë, Uegen, 2002.
4. Dedja, Bedri, “Kalamajt e pallatit tim”, Prishtinë, 2003.
5. Dedja, Bedri, “Një udhëtim i rrezikshëm”, Prishtinë, 1972.
6. Dedja, Bedri, “Presidenti i Planetit të kuq”, Prishtinë, 2008.

Literatura e përdorur

1. Bishqemi, Astrit, “Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë”, Elbasan, Sejko, 2001.
2. Demiri-Frangu, Dije, “Letërsia për fëmijë, Prishtinë”, 2013.
3. Syla, Xhevat, “Kush e shkruan poezinë”, Prishtinë, Faik Konica, 2005.
4. Mehmeti, Salajdin, “Letërsia për fëmijë”, Prishtinë, 2014.
5. Bedri Dedja, “Në kujtesën tonë...”, Tiranë, 2010.